

EPPC Albania për klientin e saj, po kërkon një **Inxhinier Projektues**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Përgjegjës për përgatitjen, planifikimin dhe monitorimin e projekteve inxhinierike;
- Qëndron në kontakt direkt me klientët për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e tyre;
- Përgjegjës për kryerjen e kontrolleve të përgjithshme të cilësisë së projektit (buxhetin, ecurinë e punimeve, performanca e personelit) dhe raporton rregullisht për statusin e projektit;
- Përcakton dhe udhëzon ekipin e projektit me detajet specifike të secilit projekt;
- Bashkëpunon dhe komunikon në mënyrë efektive me menaxherin e projektit dhe pjesëmarrësit e tjerë të projektit për të ofruar ndihmë dhe mbështetje teknike;
- Harton dokumentacionin e nevojshem të objekteve të ndërmarra nga kompania;
- Rishikon specifikat e projekteve dhe ndërmerr veprimet e duhura korrigjuese në lidhje me punimet inxhinierike.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë përfunduar studimet Master në Inxhinieri Ndërtimi;
- Të ketë mbi 5 vite eksperiencë pune në projektim godinash civile dhe infrastrukturë;
- Të ketë aftësi menaxheriale dhe aftësi për të punuar në grup;
- Njohje e mirë në përdorimin e programeve kompjuterike Ms Office, AutoCAD etj;
- Njohje me rregulloret, praktikat më të mira dhe standardet në fushën e projektimit;
- Njohës i gjuhës angleze.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.